

Universiteti Barleti
Ruga Frang Bardhi, Selitë, Tiranë

Nr. prot. 105 datë 23. 01. 2024

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
Ruga "Jordan Misja", Ndërtesa 6/, Tiranë

Nr. prot. 317 datë 13. 02. 2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

UNIVERSITETIT BARLETI
dhe
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS

duke mbajtur parasysh se:

- *Institucionet e Arsimit të Lartë janë qendra kryesore të kërkimit shkencor kombëtar dhe është detyrë e tyre të përpunojnë e të përçojnë në mënyrë krijuese njohuritë shkencore;*
- *Është në interes të IAL-ve të vendosin një raport të qëndrueshëm bashkëpunimi e shkëmbimi akademik, shkencor e kulturor;*
- *Palët synojnë shkëmbimin e dijeve dhe rinovimin e njohurive të përbashkëta përmes leksioneve të hapura, seminareve, trajnimit në laborator dhe praktikave;*
- *Palët synojnë ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përbashkët kooperimi që do të promovojë specialistë të mirëfilltë.*

Palët bien dakord të bashkëpunojnë, për krijimin e një bashkëpunimi afatgjatë në kuadër të programeve të Departamentit të së drejtës penale si pjesë të Fakultetit të Drejtësisë.



Neni 1

Qëllimi dhe Objekti

- a. Objekti i kësaj Marrëveshjeje konsiston në ofrimin e mundësive të lehtësuara për punonjësit e Shërbimit të Provës në studimet master në shkenca juridike, në ofrimin e lehtësive ndaj studentëve dhe stafit akademik të Universitetit, të cilët zhvillojnë punime shkencore dhe kërkimore në nivel masteri dhe doktorature e kualifikime në vazhdim, ofrimin e trajnimeve afatshkurtra, konferencave, seminareve apo leksioneve të hapura, të përbashkëta, përdorimin reciprok të ambienteve të institucioneve dhe shkëmbimin e materialeve të studimeve apo projekteve të realizuara;
- b. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe Universiteti Barleti lidhin këtë Marrëveshje me qëllim bashkëpunimin në drejtim të mbështetjes reciproke, shkëmbimit të përvojave dhe krijimit të mundësive për trajnime, kualifikime, zhvillimit të praktikave dhe kryerjes së studimeve të përbashkëta në fushën e të drejtës penale, drejtësisë restauruese dhe masave alternative të dënimit;
- c. Ngritja dhe realizimi i projekteve dhe programeve nga fonde dhe donatorë të ndryshëm.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në ligjin 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në ligjin 79/2020 “Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale”, në ligjin nr. 78/2020 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës”, në VKM nr. 421 datë 08.07.2021 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Shërbimit të Provës”, si dhe në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3

Informacion mbi palët

Universiteti BARLETI në vijim (Barleti) është institucion jo publik i arsimit të lartë, i cili ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi, duke synuar të zhvillojë prirjet e çdo studenti, me objektivin e krijimit të ekspertëve më të mirë, të aftë për të konkurruar në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

Misioni i Universitetit është krijimi i një institucioni akademik elitar, bazuar në praktikat e vlerat më të mira ndërkombëtare, më programe shumë-disiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në vijim (DPSHP) është person juridik publik, pjesë e institucioneve të administratës publike, me seli në Tiranë, që ushtron veprimtarinë e tij në varësi të ministrit të Drejtësisë. Misioni i Shërbimit është promovimi i përfshirjes shoqërore të personave nën mbikëqyrje, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale apo përsëritjes së tyre dhe zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë ndaj shoqërisë dhe viktimës nëpërmjet rregullave të ndërveprimit dhe riintegrimit të tij shoqëror.

Neni 4

Pikat e kontaktit

- a. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Të dhënat e tyre janë sinë Aneksin 1. Ata do të janë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proces - verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqëruar që do të dalë në zbatim të Marrëveshjes.
- b. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në Aneksin 1, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi, do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese të dhënat e personit të ri të kontaktit brenda 1 (një) javë kalendarike nga data e ndryshimit, të cilat njëkohësisht do t'i bashkëlidhen Marrëveshjes nëpërmjet ankesave.

Neni 5

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga përfaqësuesit e të dyja palëve dhe mbetet në fuqi për 3 vite nga data e nënshrkimit.

Palët janë të detyruara të respektojnë këtë Marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar.

Me përfundimin e afatit, nëse njëra nga palët nuk shpreh vullnetin për ti dhënë fund, kjo marrëveshje do të konsiderohet e rinovuar.



Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e Barletit

- a. Angazhohet në ofrimin e ambienteve për trajnime,ëorkshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
- b. Angazhohet në ofrimin e një burse studimi për punonjësit e Shërbimit të Provës për çdo vit kalendarik.
- c. Do të përfshijë në kurrikulat e veta në vijim, shërbimin e provës si dhe çeshtjet që kanë të bëjnë me të duke promovuar përpëra studentëve, kërkuesve dhe stafit akademik që kryen punime kërkimore e shkencore, tematika që kanë të bëjnë me DPSHP.
- d. Angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut DPSHP me kërkesën e tij, duke vënë në dispozicion specialistët e tij më të mirë;
- e. Shpreh vullnetin për të bashkëpunuar e sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave të Universitetit për përbushjen e misionit dhe vizionit në përputhje me legjisacionin shqiptar dhe standartet më të mira në nivel europian;

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e DPSHP

- a. Angazhohet në ofrimin e ambienteve të nevojshme për realizimin e laboratorëve, praktikave dhe specializimin e studentëve të Barletit;
- b. Garanton krijimin e lehtësive për punësimin të studentëve më të mirë në varësi të mundësive dhe potentialit të disponueshëm të institucionit dhe vënien në dispozicion stafin e nevojshëm në cilësinë e ekspertëve brenda fushës së përgjegjësisë.
- c. DPSHP angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në trajnime, workshope, forume, konferenca kombëtare, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;



- d. Angazhohet, në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje;
 - e. Angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojnë kontribut Barleti, me kërkesën e tij, duke vënë në dispozicion stafin e nevojshëm;
 - f. Personi i kontaktit do të jetë: Z.Anesti Kapllani.
3. *Palët bashkërisht bien dakord si vijon:*
- a. të organizojnë takime periodike, të paktën 1 (një) herë në vit;
 - b. të bashkëpunojnë në çdo fushë tjeter të pa listuar më sipër, brenda objektit të tyre dhe për të cilët palët kanë kapacitetet e përshtatshme profesionale.

Neni 5

Dispozita të fundit


- 1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve nënshkruese, të shprehur në një dokument të shkruar;
- 2. Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej partnerëve, sjell si pasojë prishjen e saj. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga partneri, duke argumentuar arsyet e këtij veprimi;
- 3. Kjo marrëveshje përbën 4 (katër) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipen në 4 (katër) kopje origjinale me të njëjtën vlerë ndër të cilat 2 (dy) i mban Barleti dhe 2 (dy) DPSHP.

Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:

Universiteti "Barleti"

Rektor

Prof. Dr. Suzana Guxhollli



Shërbimi i Provës
Drejtor i Përgjithshëm

Klevis Qose

